



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Bazuar në dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 2 paragrafi 4 dhe neni 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 të datës 28.06.2019, Rregullores së Kuvendit të Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, si dhe Marrëveshjes së Bashkëpunimit Nr.1-413/01-44206 të datës 17.08.2023 e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Islamic Relief Worldwide zyra në Kosovë (IRW), Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 15.09.2023, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

## V E N D I M

### PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR ISLAMIK RELIEF WORLDWIDE – ZYRA NË KOSOVË (IRW)

**I.** MIRATOHET, Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej **50.024.00 €** (pesëdhjetë mijë euro e njëzet e katër cent), konform Marrëveshjes së Bashkëpunimit Nr.1-413/01-44206 të datës 17.08.2023 e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Islamic Relief Worldwide zyra në Kosovë (IRW).

**II.** Ndarja e mjeteve të cekura në pikën **I** të këtij Vendimi bëhet me qëllim të përmbushjes së gjysmës apo 50% të obligimeve që rrjedhin nga dispozitat e Marrëveshjes së Bashkëpunimit Nr.1-413/01-44206 të datës 17.08.2023 e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Islamic Relief Worldwide zyra në Kosovë (IRW) me të cilën Komuna e Lipjanit do të participojë 43.87% të vlerës totale ndërsa pjesa e dytë apo 50% e obligimeve do të ekzekutohen vitin e ardhshëm me një Vendim tjetër që do të propozohet Kuvendit të Komunës për miratim.

Ndarja e mjeteve të cekura bëhet me qëllim të realizimit dhe implementimit të projektit të përbashkët që ka filluar këtë vit dhe do të vazhdojë edhe në vitin 2024 ku pritet të përfundojë dhe i cili projekt që ka për qëllim jetesën e qëndueshme dhe gjenerimin e të ardhurave përmes Motokultivatorëve dhe serave. Përfitues nga ky projekt do të jenë banorët e komunës së Lipjanit të cilët do të aplikojnë dhe përzgjidhen përmes një procesi të hapur dhe transparent.

**III.** Shuma e mjeteve të cekura në pikën **I** të këtij Vendimi do të ndahet nga të hyrat vetanake të Komunës, kategoria ekonomike - subvencione dhe transfere të planifikura për vitin 2023 për Drejtoratin për Bujqësi dhe Pylltari, kodi i programit 47003, fondi burimor 21/613/47003/200/00000/0421.

IV. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa, dhe Drejtorati për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

V. Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 15-400/01-53381

Lipjan, më 15.09.2023

## KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi

